



SBASHK Arsimimi sot

Dhjetor, 2024

Gazeta elektronike

SBASHK organizoi protestë me rreth 2000 anëtarë më 4 dhjetor



Udhëheqësia e shoqatave sindikale, së bashku me kryesinë e sindikatave komunale të arsimit parauniversitar dhe kryesinë qendrore të SBASHK-ut, të kryesuar nga kryetari Rrahman Jasharaj...(faqe 5)

Përfaqësues të SBASHK-ut u pritën nga kretari i PDK-së, Bedri Hamza.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut, me ftesë të kryetarit të PDK-së, Bedri Hamza, u pritën nga ky i fundit gjatë muajit dhjetor të vitit 2024...(faqe 4)

Katër vite të vështira për sindikatat në Kosovë



Flet për gazetën tonë sekretari i përgjithshëm Ymer Ymeri ... (faqe 3)

Qeveria nuk ua uroi, por SBASHK-u po ua uron



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Pas takimit të Këshillit Drejtues U mbajtën konferenca përmbyllëse me mediat në këtë fundvit, dhe duke u nisur nga fakti se as Kryeministri Kurti ... (faqe 4)

Kryeministër t'i kërkoja si vëlla 100 euro për sektorin publik e nuk i lejove, ku të shkuan miliona euro?



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Kryeministër Kurti, as ti nuk kishe pritur atë rezultat të zgjedhjeve para 4 vitesh dhe kjo të nxori jashtë kontrollit dhe fillove të ndjehesh sulltan e jo kryeministër i... (faqe 4)



Editorial

Unitet i shkëlqyer përball sfidave të mëdha



Për t'i bërë bashkë e për t'ia mundësuar lexuesit që t'i shpalosur në kohë të lirë, SBASHK edhe këtë vit përgatiti me kujdes dhe publikoi gazetën vjetore "Rrugëtimi i SBASHK-ut 2024". Shkrimet e publikuara kujtojnë angazhimet dhe përkushtimin e stafit qendror dhe të kryetarëve të nivelit komunal sindikal e të universiteteve, por edhe të shumë veprimtarëve sindikalë, në përpjekje për të realizuar detyrat konkrete në shërbim të anëtarësisë. Gjithë ajo që varej nga vetë ne u realizua në tërësi. U mbajnë shumë trajnime nëpër komunat e Kosovës duke respektuar vullnetin e anëtarësisë. U bënë shumë angazhime për të pasur dialog e për të analizuar e realizuar kërkesat e anëtarësisë, por Qeveria vazhdoi me qasjen e gabuar dhe nuk u ndal se angazhuari kundër sindikatave e me qëllim që të hesht

zërin sindikal. SBASHK-u, këtë qasje të gabuar të Qeverisë, e kritikoi arsyeshëm e hapur, qoftë përmes reagimeve e komunikatave, qoftë edhe duke organizuar dy protesta para institucioneve, por ato duke mos pasur argumente kundërshtuese, e duke vazhduar me qasjen e gabuar nuk reflektuan. Viti 2024 ishte i vështirë për sindikatat, por dëshmoi unitetin e shkëlqyer të gjithë anëtarësisë së SBASHK-ut përball sfidave. Gjithë kjo gjendje është pasqyruar në gazetën vjetore ashtu si u pasqyrua edhe bashkëpunimi i shkëlqyer me Qendrën Amerikane të Solidaritetit dhe me Unionin e Sindikatave të Arsimit të Evropës dhe me Internacionalen Botërore të Arsimit. SBASHK-u do të vazhdojë rrugëtimin me unitet të shkëlqyer dhe do të përballlet suksesshëm me të gjitha sfidat.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, flet për gazetën tonë Katër vite të vështira për sindikatat në Kosovë



Duke shprehur respekt për angazhimet e tij të vazhdueshme në realizimin e detyrave në shërbim të anëtarësisë, Këshilli Drejtues e zgjodhi Ymer Ymerin, Sekretar të Përgjithshëm të SBASHK-ut, detyrë kjo shumë me rëndësi dhe që kërkon angazhime të vazhdueshme. Ymeri e pranoi këtë detyrë dhe falënderoi kryetarin Jasharaj, dhe Këshillin Drejtues për besimin e dhënë. Ai shprehet se këtë detyrë e mori për të dhënë kontribut në realizimin e detyrave konkrete të SBASHK-ut, dhe ka bindjen se, do të arrij

me sukses, pasi shumë nga këto angazhime i ka pasur edhe si koordinator për organizim të brendshëm. Ymeri në bisedë për gazetën tonë të muajit dhjetor thekson se, katër vitet e kaluara kanë qenë shumë të vështira për sindikatat në Kosovë, ngase Qeveria Kurti kishte që nga fillimi qëndrim të gabuar ndaj dialogut dhe angazhohej për shuarjen e zërit sindikal, por falë unitetit të anëtarësisë dhe besimit dhe respektit për angazhimet e stafit qendror dhe të kryetarëve të nivelit komunal sindikal e të universiteteve, ky angazhim i Qeverisë dështoi. dhe SBASHK-u vazhdon të jetë zë i fuqishëm dhe falë përkushtimit e qëndresës nëpër sfida të kohës, gëzon respekt meritore edhe te Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës, te Internacionalja Botërore e Arsimit dhe te sindikatat simotra të Ballkanit, Evropës dhe shumë vendeve të botës. Ymeri, thekson se edhe në vitin 2025, SBASHK-u do të vazhdojë të angazhohet në shërbim të anëtarësisë duke organizuar trajnime kudo në Kosovë, bazuar në vullnetin e mësimitdhënësve me qëllim që t'u ndihmohet atyre që të marrin njohuri të reja për të qenë edhe me të suksesshëm në procesin edukativ e arsimor. Po ashtu, shton Ymeri, do të fillojmë me kohë për gatitjet për shënimin festiv të ditës së madhe të mësuesit e shkollës shqipe, do të organizojmë me sukses edhe aktivitetin tradicional për pushimin, e një numër të konsideruar të anëtarëve e anëtarëve tanë në bregdetin shqiptar, por do të organizojmë edhe shumë aktivitete e veprime sindikale bazuar në vullnetin dhe kërkesat e anëtarësisë. Ymeri, tregon se do ta vazhdojnë bashkëpunimin me Qendrën Amerikane të Solidaritetit duke organizuar aktivitete sindikale me qëllim të forcimit të zërit sindikal, por edhe për të shprehur hapur e me argumente pakënaqësitë për qasjen e gabuar të Qeverisë ndaj dialogut social, dhe sindikatave. Do të vazhdojmë ta themi të vërtetën në të gjitha format e mundshme, thekson Ymeri.

Gjatë muajit

Qeveria nuk ua uroi, por SBASHK-u po ua uron.

U mbajtën konferenca përmbyllëse me mediat në këtë fundvit, dhe duke u nisur nga fakti se as Kryeministri Kurti, dhe as ministrat e kësaj qeverie, nuk gjetën as edhe një minutë për të përshëndetur policinë tonë, e cila ka dhënë qindra shembuj në mbrojtje të atdheut, as punëtorët e arsimit, që u bënë simbol i qëndresës në vitet '90 e deri më sot, as administratën publike, as zjarrfikësit

dhe as shërbyesit e tjerë të popullit të Kosovës. SBASHK-u, ju uron Vitin e Ri punëtorëve arsimorë, policisë, punëtorëve shëndetësorë, zjarrfikësve, punëtorëve të administratës, gjithë shërbyesve civilë dhe punëtorëve në sektorin privat, me urimin që në vitin 2025 të kemi një kryeministër dhe një qeveri, e jo sulltan dhe pashallarë.

Shkoi edhe ky vit pa asnjë lajm të mirë nga Qeveria

Anëtarësi e nderuar e SBASHK-ut, kudo jeni, që nga çerdhet e deri në universitete, urojmë viti që po vjen, mos të jetë si ky që po e lëmë pas. Koleget e kolegët tanë në Arsimin Parauniversitar po bëjnë analiza të suksesit të nxënësve në përmbyllje të gjysmëvjetorit të parë dhe spontanisht edhe po përgatiten për festat e fundvitit. Është kjo koha edhe kur bëjmë vlerësime duke u kthyer nga janari e deri te ky muaji dhjetor, dhe fatkeqësisht vërejmë se shkoi edhe viti 2024 e nuk morëm as edhe një lajm të mirë nga Qeveria.

U angazhuam dhe bashkërisht dërguam shumë shkresa te Qeveria dhe MASHTI, duke përmendur kërkesat legjitime të anëtarësisë, por le që nuk u realizua as edhe njëra, por Qeveria Kurti, e në veçanti znj. Nagavci as nuk deshti të dëgjojë për to dhe i iku vazhdimisht dialogut me SBASHK-un, sepse e dinte se ne kemi fakte e argumente e ajo vetëm fjalë boshe e asgjë tjetër. Dalin e pa fije turpi flasin për rritje të dukshme pagash, por rritja ishte vetëm 28 euro teksa në Shqipëri kjo ngritje pagash është me qindra euro për vitin 2024. Iu drejtuam me kohë Ministres për të bashkëbiseduar e negociuar Kontratën e re Kolektive, por ajo i iku dialogut dhe obligimit të saj për negociim me

të vetmin qëllim, që t'ju lë pa Kontratën Kolektive, që është bazë e fortë e ruajtjes së të drejtave tuaja të punës. Kërkuam kushte të mira pune, por Qeveria ju la të zhvilloni betejën për dije me shkumës e shpuzë, pra me kushte pune të shekujve të kaluar. Ju mbloodhët 20.606 nënshkrime për nismën qytetare me kërkesën legjitime që t'u kthehet e drejta e fituar e që vitet e 90-ta të rinumëroheshin si vite kontributdhënëse. Kryetari i Parlamentit Glauk Konjufca na priti me buzëqeshje e na përgëzoi për këtë iniciativë duke premtuar se do të mundohet që kjo të dal sa më shpejt para deputetëve, por Qeveria doli edhe kundër kësaj iniciative dhe ajo këtë vit nuk arriti fare të deputetët për ta votuar dhe vazhdon realiteti i hidhur që vitet e 90-ta nuk iu pranohen punëtorëve arsimorë si kontributdhënëse, por a thua ishte kontribut i vogël mbajtja gjallë e shkollës dhe gjuhës shqipe dhe lëshimi i dëftesave e dokumenteve tjera me Republika e Kosovës?

Punëtorë të arsimit, anëtare e anëtarë të SBASHK-ut, gëzuar festat e fundvitit me besimin e plot, se viti që po vjen do të jetë vit i plotësimit të dëshirave dhe i realizimit të kërkesave tuaja të arsyeshme e legjitime.

Kryeministër t'i kërkoja si vëlla 100 euro për sektorin publik e nuk i lejoje, ku të shkuan MILIONA euro?

Kryeministër Kurti, as ti nuk kishe pritur atë rezultat të zgjedhjeve para 4 vitesh, dhe kjo të nxori jashtë kontrollit dhe fillove të ndjehesh sulltan, e jo kryeministër i një vendi, populli i të cilit kishte bërë një rrugëtim të gjatë përcjellë me lot nënash e me plot sakrifica e duke përjetuar dhunën barbare të pushtuesit serb në burgje. U ndjeve, jo kryeministër i gjithë popullit, por u bërë ndarës e përçarës dhe mllëfi yt ndaj atyre që kanë merita e që kanë hyrë në faqet e ndritura të historisë u pa kur u bërë Sulltan.

Kryeministër, më i madh ishte kur ishte i vogël në politikë dhe gëzoje mbështetje falë oratorisë dhe fjalëve të mëdha, që kur u ule në kolltuk i bastardove.

Kur ishte i vogël në politikë, e pa kolltuk, në Pejë të prisnim unë e ca individë, që besonim në idealin për bashkim kombëtar dhe na mashtrove.

Duke u nisur nga këto takime, pata besë dhe t'u drejova me: "Po të lus si vëlla, e si kryeministër, ua jep punëtorëve arsimorë, policisë, administratës, zjarrfikësve e gjithë

sektorit publik nga 100 euro në muaj që ta ndalej greva", e ti, pa pasur as edhe një ndjenjë dhembshurie më the prerazi, se nuk je në siklet, dhe më the: „vazhdo grevën deri në pranverë". Kryeministër, buxhet kishe mjaft, por nuk plotësove kërkesën modeste të mijëra punëtorëve arsimorë, të policëve dhe gjithë të punësuarve në sektorin publik. Mbase nuk na e plotësove kërkesën për 100 euro se të duheshin për dosta e për diçka tjetër.

Një këshillë nga unë Kryeministër. Ministri yt, Murati dhe gjithë shpifësit në facebook, nuk kishin lënë akuzë e shpifje e gënjeshtëri pa bërë ndaj meje dhe SBASHK-ut, dhe u dola përball. Isha edhe para organeve të drejtësisë, e di këtë shpifësi Murati. Ua prezantova gjithë faktet dhe argumentet dhe unë dhe SBASHK-u jemi faqebardhë. Mos ikni nga mediat Kryeministër, e as nga organet e drejtësisë, përveç nëse e keni mizën nën kapuç. Kryeministër, neve nuk na i dhe nga 100 euro për të blerë pak më shumë gjëra elementare, por, si duket të shkuan milionat ca andej, e ca këndej.

Përfaqësues të SBASHK-ut u pritën nga kretari i PDK-së, Bedri Hamza

Përfaqësuesit e SBASHK-ut, me ftesë të kryetarit të PDK-së, Bedri Hamza, u pritën nga ky i fundit gjatë muajit dhjetor të vitit 2024. Në këtë takim ishte diskutuar rreth kërkesave të SBASHK-ut, siq është zhvillimi i dialogut social SBASHK-Qeveri, rritja e pagave në arsim, etj. Ndërkohë, edhe i pari i PDK-së, ishte zotuar se me ardhjen e tij në Qeveri, do të realizoj rritje të pagave 50% më të larta për mësimdhënësit, digjitalizimi të shkollave dhe integrim të teknologjisë në mësimdhënie.





SBASHK organizoi protestë me rreth 2000 anëtarë më 4 dhjetor 2024



Udhëheqësia e shoqatave sindikale, së bashku me kryesinë e sindikatave komunale të arsimit parauniversitar dhe kryesinë qendrore të SBASHK-ut, të kryesuar nga kryetari Rrahman Jasharaj, më datë 4 dhjetor 2024 kishin zhvilluar një protestë duke marshuar nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës dhe duke vazhduar deri te MASHTI dhe prej MASHTI-t para Qeverisë së Kosovës.



Kërkesat kryesore të SBASHK-ut, ishin:


1. Nënshkrimi i Kontratës Kolektive.
2. Kërkojmë reflektim nga ministria dhe fillimin e dialogut.
3. Ngritje dinjitoze të pagave.
4. SBASHK-u është zëri ynë - dëgjojeni!
5. Ministre, a i ke diskutuar ndonjëherë në Qeveri kërkesat tona?
6. Mungesa e dialogut është mungesë e demokracisë.
7. Mos e mohoni kontributin e viteve të '90-ta.
8. Kundërshtojmë ndryshimet e ligjeve që dëmtojnë punëtorët e arsimit.
9. Pensionistët që kontribuuan në arsim, nuk duhet ndëshkuar.
10. Përmirësimi i kushteve të punës në institucionet arsimore.
11. Puna e mësuesit në edukimin e brezave, është e shenjtë.

Protesta ishte e organizuar dhe ishte e një niveli të kënaqshëm. Derisa menjëherë të nesërmen, Kryesia e SBASHK-ut, së bashku me kryetarët e sindikatave komunale të arsimit, i kishin analizuar rezultatet e protestës dhe kishin diskutuar lidhur me hapat e mëtejshëm sindikal.




SBASHK gjatë dhjetorit vazhdoi konsultimet për veprimet e radhës

Për ta vlerësuar rrjedhën e protestës së 4 dhjetorit, në të cilën kishin marrë pjesë rreth 2000 udhëheqës sindikalë, që nga çerdhjet e deri në universitetet dhe për të vendosur për veprimet sindikale sipas situatës aktuale, SBASHK-u edhe gjatë muajit dhjetor kishte mbajtur takime e konsultime me kryesinë dhe me udhëheqës sindikalë komunalë e të universiteteve.



SBASHK, kishte përgëzuar kryetarët dhe anëtarët e kryesive të sindikatave, për pjesëmarrje masive në protestë dhe për qëndrimin e tyre të dinjitetshëm, por kishte shpreh kritikë të arsyeshme ndaj ministres Nagavci, e cila, as pas këtij veprimi sindikal nuk kishte reflektuar, dhe prandaj u mor vendim që t'i dërgohet

edhe një shkresë me kërkesën për takim me përfaqësuesit e SBASHK-ut, dhe që të caktojë përfaqësuesit e MASHTI-t në komisionin e përbashkët, për të nisur negociimin për Kontratën e re Kolektive të Arsimit. Të gjithë pjesëmarrësit në këto takime konsultative, duke u bazuar edhe në vendimin e Këshillit Drejtues, ishin deklaruar që të vazhdohet me përpjekjet që me dialog të arrihen zgjedhje të pranueshme për kërkesat e anëtarësisë duke angazhuar edhe ndërmjetësuesin ligjor, dhe nëse as pas kësaj, nuk do të kishte reflektim nga MASHTI, atëherë do të vazhdohej me veprime sindikale deri edhe te greva e përgjithshme në tërë sektorin e arsimit, dhe për situatat që do të krijohen, fajtor i vetëm është Qeveria e në veçanti Ministria, Nagavci.



Gjatë dhjetorit SBASHK i filloi dhjetë grupe të trajnimit nëpër komuna të ndryshme të Kosovës

Gjatë muajit dhjetor, SBASHK kishte filluar me dhjetë grupe të reja të trajnimit nëpër komuna të ndryshme të Kosovës, në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social” si dhe “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”.

Dy grupe të trajnimit në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social”, gjatë këtij muaji janë mbajtur në Lipjan, me trajnerët e përzgjedhur nga SBASHK: Afrim Gashi, e Nora Ajeti. Mësimdhënësit gjatë trajnimit i ka vizituar edhe kryetari i SKAP-it, për këtë komunë, Emrush Ahmeti, i cili u ka uruar suksese sa më të larta të ngritjes profesionale.



Gjatë dhjetorit me dy grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, ka filluar edhe Gjakova, me trajneren e përzgjedhur nga SBASHK: Litvana Spahija. Mësimdhënësit janë

shprehur të kënaqur me fillimin e këtyre trajnimeve të cilat atyre u shërbejnë për avancim apo ngritje në karrierë. Derisa mbarëvajtjen e trajnimeve përgjatë vikendit, nga afër e ka përcjellur edhe kryetari i SKAP-it për këtë komunë, Zenun Nimani.



Gjatë këtij muaji me trajnime në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, kanë filluar edhe Rahoveci dhe Drenasi me trajnerët e përzgjedhur nga SBASHK, Nexhat Maçkaj, respektivisht Arbenita Gashi.



Mësimdhënësit e Rahovecit gjatë të shtunës kur kishte filluar trajnimi i kishte vizituar edhe kryetari i SKAP-it, për këtë komunë, Veli Morina, i cili ishte ndarë i kënaqur me procesin e trajnimit.



Po ashtu, mësimdhënësit të cilët e kishin filluar trajnimin në Drenas, gjatë po atij vikendi i kishte vizituar edhe kryetari i SKAP-it, për këtë komunë, Ilaz Dervishi, i cili u kishte dëshiruar mësimdhënësve, suksese sa më të larta dhe punë të mbarë.

Gjatë muajit dhjetor, trajnime janë organizuar edhe



në komunën e Vitisë dhe Gjilanit, ku kanë filluar nga dy grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”. Në Gjilan, trajnimi është udhëhequr nga trajnerja e përcaktuar nga



SBASHK, Ibadete Limani, kurse në Viti trajner ishte përzgjedhur Musli Neziri.

Për ta përcjellur mbarëvajtjen e trajnimeve dhe procesin e tyre, ishte kujdesur që t'i vizitoj mësimdhënësit edhe kryetari i SKAP-it për Gjilan, Blerim Mehmeti dhe ai Vitisë, Kemajl Bislimi.



SBASHK, pa rezultate konkrete në takim me Ministren, Nagavci



Pas konferencës për media të mbajtur nga SBASHK, Ministrja Arbërie Nagavci, së bashku me zëvendësministrin Taulant Kelmendi, realizoi një takim në MASHTI, me kryetarin e SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, nënkryetaren, Vjollca Shala, sekretarin e përgjithshëm, Ymer Ymeri dhe zyrtarin ligjor, Blendor Shatri.



Takimi ishte i shkurtër dhe përfundoi pa ndonjë rezultat konkret, pasi Ministrja Nagavci nuk shfaqti gatishmëri për të diskutuar në mënyrë konkrete mbi kërkesat legjitime të anëtarësisë, të cilat SBASHK i ka bërë publike prej kohësh.



SBASHK, shprehu keqardhje për këtë qasje të Ministres, dhe njoftoi se do të mbahet protesta e paralajmëruar e 4 dhjetorit. Gjithashtu, Këshilli Drejtues, do të shqyrtojë dhe vendosë për hapa të tjerë sindikal. SBASHK, shpreson që gjatë protestës së 4 dhjetorit, përfaqësues të MASHTI-t të takohen me udhëheqësit e protestës, me qëllim, arritjen e një marrëveshjeje të pranueshme për të dy palët.